

# STATUTI EXHK 2025

## SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";

- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

### Kreu I

#### THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

##### Neni 1:

##### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 20/01/2025 (20 Janar 2025), ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **EXHK 2025 sh.p.k**

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

**Z. Pëllumb Halili**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 22/10/1964, lindur në Këlcyrë, Përmet, e banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identitetit tip kartë identiteti me nr 035353976 i lëshuar nga MPB në datën 26/12/2019.

##### Neni 2:

##### Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

- Shitje dhe Blerje e Pasurive të Paluajtshme: Shoqëria ka për qëllim ndërmjetësimin dhe realizimin e transaksioneve të shitjes dhe blerjes së pasurive të paluajtshme, përfshirë apartamente, shtëpi, troje, njësi tregtare dhe prona të tjera. Qira dhe Menaxhim Pronash: Shoqëria ofron shërbime për dhënie me qira dhe menaxhimin e pronave të paluajtshme për llogari të palëve të treta. Konsulencë Imobiliare: Ofrimi i shërbimeve të konsulencës për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, analizën e tregut dhe këshillimin mbi investimet në sektorin imobiliar. Promovim dhe Marketing: Promovimi i pronave për shitje apo qira nëpërmjet platformave dixhitale, rrjeteve sociale dhe mediave të tjera. Ndërmjetësim në Transaksione: Ndhimë për klientët në përmbushjen e procedurave ligjore dhe administrative për transferimin e pronësisë, përgatitjen e kontratave, dhe asistencë në financim apo hipotekim të pronave. Zhvillim dhe Investime në Pasuri të Paluajtshme: Zhvillimi i projekteve të reja në fushën e ndërtimit dhe menaxhimi i investimeve të klientëve në këtë sektor. Shërbime të Tjera Ndhimëse: Ofrimi i shërbimeve shtesë, si vlerësimi i pronave, sigurimi i pronave, dhe ndërmjetësimi për kredi hipotekare. Shoqëria kryen cdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektit të saj duke përfshirë edhe veprime për pjesëmarrje në kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera.

**Neni 3:**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë:

Kohëzgjatja e Shoqërisë **EXHK 2025 sh.p.k** vendoset për një periudhë të pacaktuar kohore nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

**Neni 4:**  
**Selia**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga Sulejman Delvina, Nd. 13, Nr. Pas. 5/6-N1 ZK 8270, Tiranë**

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [pellumbhalili58@gmail.com](mailto:pellumbhalili58@gmail.com)

(3) Telefoni i shoqërisë për qëllime komunikimi telefonik është si vijon: **0697234416**

(4) Emri tregtar që shoqëria do përdor si e dhënë e njoftuar vullnetarisht është: **EXHK 2025**

**Kreu II**  
**KAPITALI, KONTRIBUTET E KAPITAL THEMELTAR,**  
**SHPËRNDARJA E KUOTAVE ETJ.**

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10,000 Lekë (Njëqind mijë). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme. Kontributi i kapitalit themeltar ka ndodhur si vijon:

1. Ortaku Themelues: **Z. PËLLUMB HALILI**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10,000 Lekë (Pesëdhjetë mijë) që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku do depozitoj kapitalin themeltar prej 10,000 Lekë (Njëqind mijë) lekë në një llogari bankare në emër të shoqërisë jo më vonë se 30 ditë nga regjistrimi në QKB.


**Neni 6:**  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga asambleja e ortakëve e një eksperti kontabël të regjistruar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



## Neni 7

### Transferimi i kapitalit

Kuotat mund t'iu transferohen palëve të treta tërësisht ose pjesërisht nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin themeltar;
- b) Blerjes - shitjes së kuotave;
- c) Trashgimisë;
- d) Dhurimit;
- d) Çfarëdo mjeti tjetër të parashikuar nga ligji.

Në rastin e transferimit të ndonjë titulli të kuotave ndaj palëve të treta, ortakët e tjerë mund të preferohen në blerjen e kuotave në proporcion me kuotat e tyre në të njëjtin çmim dhe nën kushte të njëjta të ofruara nga pala e tretë.

Në këtë rast ortaku shitës duhet t'iu komunikojë ortakëve të tjerë çmimin e ofruar nga pala e tretë, duke siguruar prova me shkrim të ofertës, dhe ortakët e tjerë do të kenë 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e letrës për të informuar ortakun shitës dhe ortakët e tjerë për vullnetin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Kur ortakët e tjerë nuk përgjigjen brenda afatit kohor, do të thotë se kanë hequr dorë nga e drejta e parablerjes në favor të tyre.

Nëse një prej ortakëve të tjerë, që ofrohet për të blerë në parablerje për pjesën e tij kuotat e ortakut të shitjes, nuk synon të ushtrojë të drejtën e parablerjes, ortakët e tjerë të cilët kanë ushtruar tashmë për pjesën e tyre të drejtën e tyre të parablerjes mund të zgjerojnë këtë të drejtë për të gjitha ose një pjesë të kuotave të ofruara në parablerje për ortakun i cili nuk synon të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes.

Në rast se më shumë ortakë dëshirojnë të zgjerojnë të drejtën e parablerjes, të ofruara për ortakun i cili nuk synon të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes në mosmarrëveshje do të ndahet në pjesë të barabarta.

Në rastin kur vetëm njëri ortak dëshiron të zgjerojë të drejtën e tij të parablerjes, parablerjes në mosmarrëveshje ofruar për ortakun i cili nuk synon të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes, do të transferohet plotësisht në të gjitha ose pjesën që ai synon për të blerë.

Në këtë aspekt, anëtarët dëshirojnë të zgjerojnë të drejtën e tyre të parablerjes duhet të njoftojë ortakun shites, vendimin e tij brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e njoftimit të mungesës për të ushtruar të drejtën e parablerjes.

Të gjitha këto komunikime duhet të jenë me shkrim.

## KREU III

### ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

## Neni 8

### Organi Vendimarrës

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;



- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) shperndarjen e fitimeve vjetore
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të vepronë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Vendimet e shumicës të Asamblese janë detyruese për ortakë që mungojnë ose janë kundër, por kanë të drejten e ankimit në rastet, afatet dhe format e parashikuara nga ligji.

## Neni 9

### Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme


Asambleja duhet të thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande që duhet t’u dërgohet ortakëve – në adresen që rezulton në Librin e Ortakëve ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtate) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 10

### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.



Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 11**

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

### **Neni 12**

#### **Përjashtimi nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13**

#### **Administrimi**

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë të emëruar për një afat 5 (pesë) vjet duke filluar nga 20/01/2025 deri në 19/01/2030.



Të dhënat e identifikimit:

(mbiemrat, emrat, adresat):

- HALILI, PËLLUMB, TIRANË

dhe specimenët e nënshkrimit:

#### Neni 14

##### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### Neni 15

##### Përgjegjësia e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.



Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;  
b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;


c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.



## **Kreu IV**

### **VITI FINANCIAR-EKSPERTET KONTABEL**

#### **Neni 16**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Neni 17**

##### **Ekspertët Kontabël**

Nëse është e nevojshme apo të kërkohet nga ligji, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave te shoqerisë do t'i besohet një audituesi të autorizuar të emëruar në mënyrën e përcaktuar me ligj me te drejte riemërimi. Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i regjistruar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakëve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka. Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se njejte te emerimit.

#### **Neni 18**

##### **Fitimet**

Fitimet neto qe rezultojne nga bilanci vjetor, zbritur 5% (pese perqind) te cilat caktohen per rezervën ligjore, dhe gjithashtu te gjitha shumat e tjera qe Asambleja vendos t'i vere menjane, u shperndahen ortakëve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara respektivisht.

Asambleja mund te vendose edhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo edhe shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

## **Kreu V**

### **PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

#### **Neni 19**

##### **Prishja dhe Likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;



Ne kete rast Ortakët merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar I apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 20**

##### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

#### **Neni 21**

##### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij ne përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

#### **Neni 22**

##### **Mosmarrëveshjet**

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.


\* \* \* \* \*

U lexua, u nënshkrua dhe u firmos.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**EXHK 2025**

**PËLLUMB HALILI**

  
(emër, mbiemër, firmë)

faqja 9 nga 9